



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:081118

Datë: 25.10.2024

Numri i dokumentit: 06352394

C.nr.2527/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Edona Zuzaki, me bashkëpunëtorin profesional Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.K. nga fshati ..., Komuna e Kamenicës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.L., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Ministria e Mbrojtjes - Forca e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i diferencës në pagë, me vlerë të kontestit 1, 904.04 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 08.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit G.K. nga fshati ..., Komuna e Kamenicës dhe DETYROHET e paditura Ministria e Mbrojtjes - Forca e Sigurisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, që për periudhën kohore 01.03.2021– 28.07.2021, për gjithsej 5 muaj, duke llogaritur diferencën nga 105.78 euro në muaj, t'ia paguaj paditësit shumën prej 528.9 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 13.03.2024, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, sa i përket periudhës kohore 01.02.2020 – 01.03.2021, në shumën prej 1, 375.14 euro.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarve të tij, më datë 13.03.2024, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensim e diferencës në pagë, me vlerë të kontestit 1, 904.04 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura në vendin e punës në Gjilan dhe nga data 06.12.2019, ka pasur gradën ushtar i klasit të parë – OR-3, ndërsa nga data

08.07.2021 e tutje, ka gradën Tetar OR-4. Me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.09/117 të datës 22.01.2020 është aprovuar Rregullorja Nr.02/2020 për Pagat, Shtesat mbi Pagë dhe Kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Bazuar në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 të kësaj rregullore, ndërlidhur me shtojcën nr.1, ka theksuar se është përcaktuar që paga bazë sipas gradës së tij OR -3 duhet të paguhet në shumën prej 580.70 euro bruto, ndërsa paditësi në vitin 2020 e 2021, për këtë gradë është paguar në shumën prej 474.92 euro bruto. Diferenca e papaguar është 105.78 euro për muaj, ndërsa për periudhën 01.02.2020 – 28.07.2021 janë gjithsej 18 muaj që paditësi nuk është kompensuar plotësisht sipas gradës së tij. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shumës prej 1, 904.04 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar: 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 31.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se shërbimi në FSK është i rregulluar dhe përcaktuar me ligj të veçantë, ku janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e pjesëtarëve të FSK-së, e nga ky ligj është përcaktuar se pagat, shtesat mbi pagë dhe llojet e tjera të kompensimit përcaktohen me akt veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, ashtu që më datë 14.02.2020 është publikuar në Gazetën Zyrtare edhe rregullorja nr.02/2020 që përcakton këto kompensime, e aprovuar nga Qeveria e Kosovës. Në mungesë të mjeteve buxhetore, që nga momenti i miratimit të rregullores, e njëjta nuk ka gjetur zbatim, prandaj me vendimin nr.10/21 të dt.28.07.2021 të Qeverisë së Kosovës është pezulluar shtojca e rregullores me të cilën janë përcaktuar pagat sipas gradave ushtarake dhe ekuivalenca e personelit. Ka konsideruar se kërkesa e paditësit është e parashkruar bazuar në dispozitat e nenit 341 dhe 342 të LMD-së dhe nenit 87 të LP-së, pasi që nga hyrja në fuqi e rregullores e deri në paraqitjen e padisë kanë kaluar më tepër se 3 vite. Lartësinë e kërkesëpadisë nuk e ka kontestuar. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilën refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën më datë 05.01.2016 (fakt i vërtetuar nga kontrata e punës) dhe më datë 06.12.2019 është emëruar me gradën OR-3, Ushtar i klasit të parë (urdhër emërimi, referencë 1/2411/2019), pra për periudhën objekt kontesti, ka pasur gradën OR-3, ndërsa për vitin 2020 dhe 2021 është paguar në shumën bruto prej 474.92 euro në muaj (lista e pagës e lëshuar nga BRK në emër të paditësit).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata për vendosje në këtë çështje kontestimore ka zbatuar dispozitat ligjore nga Ligji Nr.06/L-124 për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës që në nenin 2 përcakton se “Ky ligj zbatohet për Forcën e Sigurisë së Kosovës, përfshirë pjesëtarët aktivë, rezervë, kadetët, rekrutët dhe personelin civil të saj” dhe nenin 11, paragrafi 1 dhe 3 se “Të drejtën në pagë, shtesat mbi pagë dhe llojet tjera të kompensimit e kanë të gjithë pjesëtarët e FSK-së. Pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera, përcaktohen dhe paguhen në përputhje me dispozitat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi, me akt të veçantë nënligjor të nxjerrë nga Qeveria”.

Akti i veçantë nënligjor është nxjerrë me Vendimin Nr.09/117 të datës 22.01.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se “Aprovohet Rregullorja për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera përgjegjëse”.

Rregullorja nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, në nenin 5, paragrafi 1 dhe 2 përcakton se “I gjithë personeli në MM dhe FSK kanë të drejtë në pagën bazë të gradës, të funksionit që kanë, Paga bazë përcaktohet për gradën, funksionin që bartë, në pajtim me Shtojcën nr. 1 bashkëngjitur dhe pjesë përbërëse e kësaj rregullore. Përcaktimi i pagës bazë bëhet me aktin e gradimit/emërimit në shërbim ose aktin e themelimit të marrëdhënies së punës”; ndërsa në nenin 22, shtojcën nr.1 – Tabela e pagave me rangun e gradave ushtarake dhe personelit civil ne MM dhe FSK përcakton se “Grada OR3, personeli i punësuar CS2 ka nivelin e pagës në shumën prej 580.70 euro”.

Ndërsa me Vendimin Nr.10/21 të datës 28.07.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës është përcaktuar se “Pezullohet përkohësisht së zbatuari neni 22 (Shtojca I) i Rregullores (QKR) Nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, deri në plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Obligohet Ministria e Mbrojtjes që sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi të përgatis dhe t’ia propozojë Qeverisë për miratim Projekt-Rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores (QRK) Nr. 02/2020 për pagat, shtesat mbi pagë dhe kompensimet tjera në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Obligohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi”.

Në rastin konkret, gjykata gjen se nuk është kontestuese gjendja faktike se që nga koha e hyrjes në fuqi të Rregullores Nr.02/2020 për pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e tjera – më datë 31.01.2020, e deri më datë 28.07.2021 kur e njëjta është pezulluar së zbatuari sa i përket

shtojcës nr.1 për tabelën e pagave me Vendimin Nr.10/21 të Qeverisë së Kosovës, paditësi nuk është kompensuar sipas pagës së përcaktuar në nenin 22, shtojcën 1 të kësaj rregulloreje.

Mos zbatimin e këtij vendimi, e paditura e arsyeton me mungesën e mjeteve buxhetore duke theksuar se nga kjo arsye edhe është pezulluar më pastaj e njëjta rregullore në këtë pikë.

Thënë këtë, gjykata vlerëson se për periudhën kohore derisa nuk është pezulluar rregullorja sa i përket shtojcës nr.1 me vendim të qeverisë, e njëjta ka qenë në fuqi dhe ka prodhuar efekt juridik, ndërsa mungesa e mjeteve buxhetore nuk e justifikon mos zbatimin e saj për atë periudhë.

Meqenëse e paditura është thirrë në parashkrim të kërkesës, gjykata vlerësoi këtë pretendim dhe gjeti se kërkesa e paditësit është pjesërisht e parashkruar. Bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, të gjitha kërkesat monetare nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda afatit prej 3 vite. Në këtë rast, paditësi ka paraqitur padinë më datë 13.03.2024, prandaj edhe llogaritja e kërkesës së tij duhet të jetë nga muaji Mars 2021, kurse pjesa tjetër 01.02.2020 –01.02.2021, është e parashkruar.

Nga kjo arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që për periudhën kohore 01.03.2021 – 28.07.2021, për gjithsej 5 muaj, duke llogaritur diferencën nga 105.78 euro, detyroi të paditurën t'ia kompensojë shumën prej 528.9 euro.

Diferenca e shumës së papaguar – lartësia e kërkesës nuk ishte kontestuese nga e paditura.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që i refuzoi të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësit për periudhën kohore 01.03.2020 – 01.02.2021, si të parashkruar.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenet 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2527/24, më datë 08.10.2024

Gjyqtarja,

Numri i lëndës: 2024:081118
Datë: 25.10.2024
Numri i dokumentit: 06352394

Edona Zuzaki

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimi në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.